

RELACION

mbi

VENDIMIN

“PËR BUXHETIN E VITIT 2017”



Buxheti Bashkia e Sarandes

“Saranda është një qytet me më shumë se 2000 vjet histori, i pasur në vlera të rralla të trashëgimisë kulturore dhe arkeologjike shqiptare, por edhe evropiane. Kjo trashëgimi e pasur arkeologjike e gërshetuar me bukuritë e natyrës, përbën bazën më të rëndësishme për të promovuar zhvillimin e imazhit aktual të Sarandës, si një destinacion i turizmit klasik botëror. Aktualisht, Parku Kombëtar Arkeologjik i Butrintit është gjeneruesi parësor i turistëve ndërkombëtarë”.

Te nderuar Keshilltare!

Buxheti per vitin 2017 ka kaluar ne nje proces diskutimi dhe analizimi te problematikave dhe sfidave emergjente, proces ky i cili solli edhe listimin e projekteve afatshkurtra dhe afatmesme. Gjate ketyre muajve, takimet dhe diskutimet individuale dhe te organizuara me komunitetin si dhe marrja e shqetesimeve prej tyre kane ndihmuar ne per te percaktuar nevojat e shumta dhe mundesi te kufizuara per t’u realizuar ne nje kohe afatshkurter.

Ky vit do te jete nje tregues i punes sone me mundesite maksimale, duke bere keshtu te mundur permbushjen e detyrimeve, pergjegjesive dhe premtimeve tona.

Ne, Bashkia Sarande do te punojme me rigorozitet dhe pergjegjesi nepermjet zbatimit te ligjit, transparences se hartimit te buxhetit per te perdorur parate ne menyre eficente per gjerat e duhura, me besimin se vetem keshtu mund te ndryshojme per tu zhvilluar.

Per kete po punojme ne vijimesi per krijimin e nje administrate sa me eficente, nepermjet se ciles do realizohet sherbimi ndaj qytetareve, por edhe kjo gje do kohen e vete pasi korrigjimi i menjehershem ka



pasoja financiare. Gjithashtu modernizimi i punes ne admistraten publike nepermjet futjes se teknologjive te reja te komunikimit do jete nja alternative qe jemi duke e implementuar dhe mbeshtetur. Ne zonen Sarandes ka ende zona te diferencuara persa i perket infrastruktures rrugore te cilat bejne te veshtire njetrajtesimin e ofrimit te sherbimeve publike ne te gjithe teritorin e bashkise. Si edhe kete vit qe kaloi, por edhe per vitin aktual po punohet per te zvogeluar keto diferencime ne menyre qe e gjithe bashkia e madhe te marri sherbime me te njejtin nivele gjithe teritorin te saj.

Vemendja kryesore do ti kushtohet sidomos sherbimeve publike; pastrimi dhe mbrojtja e mjedisit, mirembajtja e infrastruktures ekzistuese, permiresimi me uje te pijshem, permiresimi dhe zgjerimi i rrjetit te ndricimit publik, permiresimi i cilesise ne rrjetin ekzistues, permiresimi i kushteve ne ambientet e mesimdhenies te cikleve parashkollore dhe ato parauniversitare.

Nje nisme e cila eshte ne vijimesi eshte permiresimin e mardhenieve me biznesin duke e konsideruar me teper si partner se sa si nje debitor kundrejt bashkise. Kjo do te sherbente per te krijuar nje klime pozitive te zhvillimit dhe funksionimit te bizneseve, mikpritese per turistat vendas dhe te huaj. Promovimi i territorit me vlerat e veta turistike te trashegimise, te artit te kultures dhe tradites do te ndihmojne ne rritjen e ekonomise.

Turizmi ujqor dhe prodhimi i produkteve nenujqore jane nje nder burimet me kryesore te te ardhurave si dhe nje nder shtyllat kryesore te ekonomise ne Bashkine e Sarandes. Zonat e prodhimit bujqesor ne Sarande perballen me nevojën e madhe per infrastrukture per kullim dhe vaditje. Me zbatimin e reformes territoriale sektori i kullimit ju delegua Bashkise, dhe per vitin 2016 jane bere nje sere punimesh dhe investimesh te cilat jane ende ne proces, me qellim permiresimin e infrastruktures se kullimit dhe te jepet fund njehere e mire ketij problemi te madh dhe jetik per ekonomine e bujqesise. Tashme kjo eshte pergjegjesi e jona por qe kerkon edhe angazhimin e vete popullsise qe banon ne keto zona.

Pasurite e natyres, pyjet, kullotat, deti dhe pasuria e tij nenujqore, liqeni i Butrintit i cili mbart vlere jo vetem ekonomike por eshte edhe nje aset i shtuar turistik per Saranden e Ksamilin per vete vecorine e tij qe ka per rritjen e midhjes se Butrintit, jane vleresuar dhe konsideruar nje burim per zhvillimin e konomik per zonen.

Sarande eshte nje nga Bashkite me te privilegjua persa i perket pozicionit te saj gjeografik. Ne gjithe teritorin administrativ, ka nje vije bregdetare te konsiderueshme me siperfaqe te shfrytezueshme te plazheve ne **50,000 m²** nga te cilat **8,500 m²** jane publike. Saranda eshte nje qytet shume atraktiv sidomos per sezonin veror, nje destinacion i preferuar per turista nga te gjitha vendet e botes, dhe ky eshte nje tregues pozitiv per te ardhmen ekonomike te popullsise te kesaj zone. Po aq atraktiv dhe premtues eshte edhe Ksamili i cili gjithnje e me shume behet nje destinacion turistik i dashur sidomos per vendet e rajonit.

Shtylla e kryesore, si sektor udheheqes i ekonomise per Bashkine e Sarandes eshte turizmi dhe akuakultura. Legjistacioni ne fuqi e ka permiresuar disi situaten ne lidhje me mardhenien bashki-biznes, por jane vete qytetaret, pronare te ketyre bizneseve qe duhet te ndergjegjesohen, te tregohen korrekte dhe transparente per te pasur nje lidhje dinjitoze korrekte dhe transparente me shtetin per mardheniet e tyre fiskale. Kjo lloj mardhenie jo vetem qe krijon nje klime pozitive persa u perket te ardhurave por sherben per te forcuar mardhenien e partneritetit biznes-bashki dhe per te eliminuar pengesat per nje bashkepunim te shkelqyer per zhvillimin e qytetit tone dhe per rritjen e metejshme te ketyre bizneseve. Jemi akoma larg te qenit te vetedijshem persa u perket detyrimeve fiskale edhe pse kjo eshte rruga e duhur per rritje ekonmike dhe zhvillim eshte formalizimi i te gjitha aktiviteteve te bizneseve.



Saranda ka histori, tradita, kulturen, mikpritjen dhe vlerat njerezore. Mbrojtja e ketyre vlerave, zhvillimi dhe promovimi i tradites dhe trashegimise kulturore nepermjet gjallerimit te jetes kulturore artistike dhe sportive dhe promovimit te vazhdueshem te tyre i japin me shume vlera qytetit.

Saranda eshte nje qytet me nje popullsi relativisht te re dhe aktive. Ne Sarande mesojne dhe edukohen reth 4,357 nxenes dhe student te niveleve te ndryshme te arsimit. Ne territore te ndryshme verehen diferencime ne kushtet e mesimdhenies. *Permiresimi i kushteve dhe perafrimi i standarteve* do jete nje nga sfidat kryesore te punes sone.

Jam e bindur dhe mirepres mbeshtejten dhe bashkepunimin tuaj!

KRYETARE

Florjana KOKA

TREGUESIT KRYESOR TË BUXHETIT PËR VITIN 2017

Buxheti i Bashkise Sarande per vitin 2017 eshte planifikuar 1,464,638 mije leke ;

- **379,500** mije leke nga te ardhurat e veta
- **104,613** mije leke nga transferta e pakushtezuar
- **84,434** mije leke nga te ardhurat e paperdorura per 2016
- *603,421 mije leke nga buxheti i shtetit per investime*
- *86,670 mije leke nga transferta specifike*
- *206,000 mije leke nga transferta e kushtezuar*

1. **TË ARDHURAT**

Te ardhurat e pergjithshme per vitin 2017 te Bashkise Sarande parashikohen **1,464,638 mije leke**. Sipas burimeve te financimit ndahen si me poshte:

- ❖ **Te ardhurat nga burimet e veta**, ku perfshihen te ardhurat tatimore (nga taksat) dhe te ardhurat jotatimore (nga tarifate per sherbimet publike)
- ❖ **Te ardhura nga burime qendrore** ku perfshihen *transferta e pakushtezuar, transferta specifike* per funksionet e deleguara si dhe *transferta e kushtezuar* e destinuar per personat me aftesi te kufizuara si edhe *financimet nga FZHR* per investime ne infrastrukturen publike vendore.

1.1 **Te ardhurat e veta vendore**

Te ardhurat nga burimet e veta vendore perbejne burimin kryesor te te ardhurave te bashkise, planifikimi dhe shperndarja e te cilave ne baze te ligjit 139/2015 eshte e drejte e bashkise dhe keshillit bashkiak. Specifika e ketyre te ardhurave eshte se edhe nese nuk harxhohen brenda nje viti fiskal, trashegohen ne vitin tjeter fiskal. Planifikimi i te ardhurave nga taksat dhe tarifate eshte



mbeshtetur ne paketen fiskale 2017 e cila permban llojin e taksave, bazen e taksueshme, kategorite e bizneseve dhe kestet e pagesave pergjate gjithe vitit, si dhe menyren e vjeljes se tyre. Gjithashtu planifikimi i te ardhurave u be ne bashkepunim me administrates se Bashkise, me Njesine administrative dhe agjenteve tatimore. Ky bashkepunim u be per te siguruar te ardhurat e mjaftueshme per permiresimin e metejshem te sherbimeve qe ofron bashkia ndaj komunitetit ne te gjithe territorin.

Tabela 1. Te ardhurat e veta te Bashkise per vitin 2017

nr	Te ardhurat e veta	Plan 2017
I	Nga burimet e veta vendore	379,500
-	Te ardhura tatimore-taksat	218,500
-	Te ardhura jotatimore -tarifat	161,000
II	Te ardhura te trasheguara nga viti i meparshem	84,434
III	Te ardhura nga burime qendrore	104,613
-	Transferta e pakushtezuar	104,613
	Totali	568,547

1.2 **Te ardhurat nga burimet e veta vendore** perbejne burimin kryesor te te ardhurave te bashkise, te cilat perbehen nga taksat,tarifat dhe te ardhura te tjera. Pjesen me te madhe te tyre e zene taksat (rreth 59 %).

- Zerat e taksave dhe tarifave qe ndikojne kryesisht ne planin e te ardhurave jane taksa mbi pasurine e palujtshme me 21 % ,tarifa e pastrimit me 20%

Tabela 2. Te ardhurat nga burimet vendore

Nr	Te ardhura nga burimet e veta vendore	Plan 2017
1	Te ardhura nga taksat	218,500
2	Te ardhura nga tarifate	113,000
3	Te ardhura te tjera	48,000
	Totali	379,500



Tabela 3. Te ardhurat nga burimet qendrore

Nr	Te ardhurat nga burimet qendrore	Plan 2017
I	Transferta specifike	86,670
II	Transferta e kushtezuar	206,000
IV	Te ardhurat nga FZHR	603,421
	Totali	896,091

Tabela 4. Plani i te ardhurave te vet ate Bashkise Sarande per vitin 2017

	LLOJET E TE ARDHURAVE	Plani 2017
I	TE ARDHURAT NGA BURIMET E VETA GJITHESEJ	379,500
b	TE ARDHURAT TATIMORE/ NGA TAKSAT VENDORE	218,500
	Tatim i thjeshtuar mbi Biznesin e vogel	5,000
	Taksa mbi ndertesat	78,000
	Taksa trualli	3,000
	Taksa mbi token bujqesore	6,000
	Taksa vjetore te mjeteve te perdorura	15,000
	Taksa per zenie hapësire publike	36,000
	Taksa per fjetje ne hotel	19,000
	Taksa per ndikim ne infrastrukture nd. e reja	28,000
	Taksa mbi kalimin e drejte te pronesisë	10,000
	Taksa per tabelen	1,000
	Taksa per zenie hapësire publike per reklama	8,000
	Te ardhura nga vitet e kaluara, debitore	9,500
c	TE ARDHURAT JOTATIMORE	161,000
1	Te ardhura nga tarifate	113,000
	Tarife per Sherbime publike	76,000
	Tarife Parkimi	15,000



	Tarife per Sherbime te tjera administrative	22,000
2	Te Ardhura te tjera	48,000
	Qera te ndryshme	10,000
	Bileta sporti	1,000
	Sponsorizime dhe Projekte te financuara nga BE	7,000
3	Pagesa te tjera kthyer si parapagesa	15,000
	Pagesa nga kopeshte ,cerdhe,konvikti	15,000
4	Te Ardhura nga Legalizimet	15,000
II	Transferta e pakushtezuar	104,613
	Transferta e pakushtezuar	104,613
III	Gjendja e vitit 2016	84,434
3	Te Ardhura te paperdorura 2016	84,434
	Shuma e te ardhurave vendore	568,547

- **Ndikimi ne te ardhurat e veta perqindja e cdo takse dhe tarife**

➤ Paguesit e taksave dhe tarifave vendore jane bizneset, familjaret dhe institucionet. Peshen me te madhe e mbajne familjaret te cilet perbejne rreth 84.4 % te taksapaguesve dhe me pas vjen biznesi i vogel me 14 % te totalit te te ardhurave. Me poshte paraqiten kategorite e taksapaguesve te ndara sipas lagjeve dhe njesive administrative.

Tabela 5

Numri i taksapaguesve sipas grupimeve

Kapaciteti I taksapaguesve sipas grupimeve (numri)						
Nr	Bashkia Sarande	Totali	Familjet	Biznes i vogel	Biznes i madh	Institucione
1	NjA sarande	16,068	13,751	1,993	307	17
	Lagjia 1	3,465	2,688	636	137	4
	Lagjia 2	1,718	1,338	337	40	3



	Lagjia 3	2,295	1,703	554	32	6
	Lagjia 4	4,618	4,217	332	65	4
	Lagjia 5	3,972	3,805	134	33	
2	NjA te tjera	2,514	1,885	611	18	-
	Nj.A Ksamil	2,514	1,885	611	18	
	TOTALI	18,582	15,636	2,604	325	17

-Ne tabelen e meposhtme paraqitet numri i bizneseve sipas aktivitetit qe kryejne. Pesha kryesore e bizneseve eshte kategoria e Njesive tregtare dhe sherbimi me 78% kundrejt totalit, kurse njesite e prodhimit zene vetem 4%.

Tabela 6 Kapaciteti i bizneseve te vegjel sipas netyres

Kapaciteti i bizneseve te vegjel sipas natyres(numri)						
N r	Bashkia Sarande	biznesi I vogel	Nga kjo			
			Njesi tregtare dhe sherbimi	Njesi prodhimi	Profesione te lira	Ambulante
1	NjA sarande	2010	1478	84	113	335
	Lagjia 1	640	555	19	66	
	Lagjia 2	340	309	17	14	
	Lagjia 3	560	183	13	29	335
	Lagjia 4	336	313	20	3	
	Lagjia 5	134	118	15	1	
2	NjA te tjera	611	569	32	5	5
	Nj.A Ksamil	611	569	32	5	5
	TOTALI	2621	2047	116	118	340



I. Te ardhurat nga taksat:

- **Të ardhurat e taksave mbi ndertesat** rriten me rreth 26,000 mije LEK, duke kapur nivelin 78,000 mije LEK ose, nga 52,000 mije LEK ose në buxhetin fillestar 2015. Te ardhurat nga kjo takes konsiderohet burimi kryesor i te ardhurave dhe gjithmone ne rritje te pasi ka pak vite qe eshte aplikuar dhe kerkon kohën e vet per tu saktësuar plotesisht kapacitetet e taksueshme.
- **Te ardhurat nga taksa e truallit:**
Kjo takse u vendos per here te pare ne paketen fiskale 2016 dhe me nje perlllogaritje fillestare eshte planifikuar **3,000 mije LEK**. Pervec efektit ne te ardhurat kjo takes nxit edhe sistemimin e trojeve te lira dhe perdorimin e tyre. Per vitin e kaluar nuk pati sukses realizimi i saj , por planifikimi nuk ndryshoi pasi bazohet ne kapacitetet e taksueshme.
- **Taksa per zenien e hapësirave publike.**
Per 2017 eshte planifikuar **36,000 mije LEK** me nje ulje rreth 15,000 LEK , duke u nisur nga mosrealizimi i planit te vitit 2016, per shkak te planifikimit jo te sakte nisur nga kapacite jo reale hapësirash te taksueshme.
- **Taksa e fjetjes ne hotel.**
Kjo takse eshte takse premtuese per vete kapacitetin totalier qe ka Saranda, por ka veshtiresite e saj per tu aplikuar ne menyre te sakte dhe transparente. Per vitin 2017 eshte planifikuar **19,000 mije LEK** nga 14,000 LEK ne viti 2016, por akoma me premtuese eshte kjo natyre takse per bashkine e Sarandes.

Te ardhura nga Taksa e ndikimit ne infrastrukture rritet me rreth 15,500 mije LEK ne krahasim me vitin 2016 , ose **28,000 mije LEK** nga 12,500 mije LEK. Planifikimi per kete takse ka qene I ndryshem per arsye te ndryshimit te kuadrit ligjor ne menyre te vazhdueshme e cila ndikon direct ne rritjen ose jo te te ardhurave nga kjo takse. Per vitin 2017 pritet miratimi i Plani i Pergjithshem Vendor dhe kjo pritet te sjelle edhe rritjen e ndertimeve te reja.

Te ardhurat nga taksat vendore

II. Te ardhurat jo tatimore:

- **Te ardhurat nga tarifat e sherbimeve publike** per pastrimin, largimin e mbetjeve dhe gjelberimin dhe ndricimin publik eshte planifikuar me nje rritje rreth 16,937 mije LEK ose ne **76,000 mije LEK** nga 59,063 mije LEK. Kjo tarife eshte planifikuar te paguhet ne baze mujore ne faturen e furnizimit me uje , prane ndermarjes se Ujesjelles Kanalizimeve SH.A Sarande e cila



sherben si agjent tatimor. Ritja e planifikimit vjen si pasoje e saktesimit te bazes se taksueshme, por edhe te realizimit me te larte se plani per 2016-en.

- **Te ardhura nga Tarifa e parkimit** eshte nje e ardhur qe vjen nga aplikimi i parkimit me pagese ne nje pjese te rrugeve te qytetit te miratuara nga Keshilli Bashkiak. Per vitin 2016 per shkak edhe te punimeve ne funksion te investimeve publike ne infrastrukturen rrugore, nuk ishte e mundur realizimi i planit vjetor te te ardhurave nga kjo tarife por me shume mundesi kjo situatë do te ndikojë edhe ne te ardhurat per kete vit. Planifikimi per vitin 2017 parashikohen te jene **15,000 mije LEK**.

III. Te ardhura te tjera

- **Te ardhura nga dhënia me qera e aseteve ne pronesi te Bashkise.**

Te ky ze parashikohen te ardhurat prej **10,000 mije LEK**. Ketu perfshihen asete te bashkise te dhëna me qera, bazuar ne legjistaconin aktual “per dhënie me qera ,enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shteterore”. Per kete vit nuk ka ndryshim kontratash dhe te ardhurat priten te jene po ato qe kane qene planifikuar edhe nje vit me pare.

- **Te ardhura nga financim projektsh me BE**

Per vitin aktual jane bere nje sere aplikimesh me projekte te ndryshme kryesisht ne fushen e turizmit , ne kuader te programit IPA, me financim nga BE. Eshte fituar nje project ne “Interreg MED Programme” me titull “CONSUME-LESS” , prej te cilit priten **2,500 mije LEK** financime per vitin 2017.

I. Të ardhurat nga transferta e pakushtezuar eshte e ardhur nga qeverisja qendrore per qeverisjen lokale, per te financuar funksione te qeverisjes vendore te cilat nuk mund te mbuloohen nga te ardhurat e veta. Sipas ndarjes se re teritoriale formula per ndarjen e kesaj transferte eshte bazuar tek popullsia relative. Per vitin 2017 me ligjin 130/2017 “Per buxhetin e vitit 2017” eshte miratuar transferta e pakushtezuar **104,613 mije LEK** per Bashkine e Sarandes.

II. Te ardhurat nga buxheti i shtetit jane nje ze me vete ne buxhet por qe procedohen nepermjet strukturave dhe procedurave ne Bashki .

○ **Investimet nga Buxheti** Bashkia ka perfitur edhe perfiton fonde nga buxheti i shtetit nga Fondit te Zhvillimit te Rajoneve nepermjet projekteve te aplikuar nga ana e pushtetit vendor. Bashkia ka ne proces kontratat e lidhurane vitet e meparshme por edhe fonde te planifikuar per projekte te aplikuar per infrastrukturen e qytetit.

III. Transferta specifike sipas funksioneve.

○ **Konviktet e arsimit parauniversitar.** Per vitin 2017 parashikohet qe Bashkise Sarande ti akordohet fondi per konviktin e shkolles se mesme ne te cilen perfshihen, fondi i pagave dhe sigurimeve shoqerore dhe fondi per shpenzime operative dhe investime. Standartet dhe kriteret e



sherbimit do te kryhen ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi. Fondi i planifikuar per kete vit buxhetor do te jete **18,051 mije leke**

○ **Sherbimi per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimi (PMNZSH)**. Ne transferten specifike te vitit 2017, jane fondet per PMNZSH. Ne kete fond bejne pjese fondi I pagave, sig. shoqerore si dhe fondi per shpenzimet operative .Standartet e ofrimit te sherbimeve do te behen ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi. Shuma e planifikuar per kete funksion eshte **13,681 mije lek**.

○ **Personeli mesimor dhe jomesimor ne arsimin parashkollor dhe personeli jomesimor ne arsimin parauniversitar**. Ne transferten specifike te vitit 2017, jane fondet per personelin arsimor dhe ate ndihmes per arsimin parashkollor si dhe per personelin ndihmes per arsimin parauniversitar me perjashtim te arsimit te mesem profesional.

Per arsimin parashkollor per vitin 2016 eshte alokuar nje fond prej 42,437 mije leke i cili ka qene i pamjaftueshem per fond pagash dhe sigurime shoqerore keshtu qe per vitin 2017 planifikimi per kete kategori do te jete ne shumen prej **45,468 mije leke** dhe kjo shume do te paraqitet si kerkese prane Ministrise se Arsimit dhe Sportit.

Per personelin mbeshtetes te arsimit baze arsimin 9 –vjecar eshte alokuar gjithashtu nje fond i mjaftueshem per paga dhe sigurime per vitin 2017 per te perballuar shpenzimet baze ne Shumen **2,321 mije lek**.

○ **Administrimi i pyjeve**

Ne transferten specifike te vitit 2017, jane fondet per Sherbimin pyjor. Ne kete fond bejne pjese fondi i pagave, sig. shoqerore si dhe fondi per shpenzimet operative. Standartet e ofrimit te sherbimeve do te behen ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi. Shuma e planifikuar per kete funksion eshte **1,843 mije lek**.

○ **Ujitja dhe Kullimi**

Ne transferten specifike te vitit 2017, jane fondet per Ujitjen dhe Kullimin. Ne kete fond bejne pjese fondi i pagave, sig. shoqerore si dhe fondi per shpenzimet operative .Standartet e ofrimit te sherbimeve do te behen ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi. Shuma e planifikuar per kete funksion eshte **5,307 mije lek**

IV. Transferta e Kushtezuar

Transferta e kushtezuar perbehet prej funksionit te deleguar per *sherbimin e Gjendjes civile*, **3,721 mije leke**, *Qendres Kombetare te Biznesit* **1,930 mije lek**, fondet per *mbeshtetje ekonomike per familjet ne nevoje* **15,000 leke** dhe *personat me aftesi te kufizuar* **191,000 mije lek**. Nga transferta e kushtezuar financohen edhe *transporti i arsimitareve dhe i nxenesve* te arsimit parashkollor, 9 vjecar dhe arsimit te mesem.



2. SHPENZIMET

Totali i shpenzimeve publike për vitin 2017 nga te ardhurat vendore dhe transferten e pakushtezuar është planifikuar të jetë **568,547 mij LEK**.

Gjate vitit 2017, permes ketyre shpenzimeve te planifikuara, Bashkia Sarande synon te permbushi detyrimet e percaktuar ne ligj ne keto programe:

2.1 Administrata vendore.

Ne kete program planifikohen shpenzime per administraten e cila eshte ne funksion te programeve te tjera te punes, vecanerisht ne vazhdimesine e zhvillimit te kapaciteteve menaxhuese ne te gjithë nivelet e institucionit, per te mundesuar zbatimin e politikave sipas kuadrit ligjor ne fuqi. Politikat e Bashkise Sarande ne vazhdimesi do te jene drejt krijimit te nje strukture menaxhuese cilesore, nepermjet krijimit te mundesive per perthithjen e burimeve njerezore profesionale ne funksion te zbatimit te qellimit dhe objektivave te Bashkise dhe ofrimit te sherbimit te qytetareve. Ne objektivat e Bashkise do te jete trajnimi dhe kualifikimi i punonjesve me qellim kryerjen e sherbimit ne menyre profesionale. Dixhitalizimi i administrates publike do te jete nje nga prioritetet tona, me qellim sherbimin elektronik te qytetareve dhe biznesit. Prioritet do te jete transparenca dhe permiresimi i sherbimeve ndaj qytetareve te cilet do te kene mundesi te aplikojne ne menyre elektronike dhe te marri sherbimin ne afatin e duhur.

Zbatimi i buxhetit per shpenzime per paga te personelit, do te bazohet tek numri i punonjesve dhe niveli i pagave, sipas klasave e shtesave mbi page ne perputhje me aktet nenligjore ne fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal te miratuar. Pagat, shtesat mbi pagat e punonjesve do te behen sipas Vendimit te Keshillit te Ministrave nr.165, date 02.03.2016 "Per grupimin e njesive te qeverisjes vendore per efekt page dhe caktimin e kufinjve te pagave te funksionareve te zgjedhur dhe te emeruar te nepunesve civil e punonjesve administrative te njesise se qeverisjes vendore". Ne vitin 2017 pritet te rritet paga minimale deri ne nivelin 37,000 dhe kjo rritje do pasqyrohet ne planifikimin e fondit te pagave dhe sig. shoqerore.

Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqerore per vitin 2017 planifikohet te jete **184,397 mije leke**, me nje strukture ne perberje te se ciles do te jene **292 punonjes**. Nepermjet kasaj strukture do te behet e mundur permbushja e detyrave dhe pergjegjesive per gjithë territorin e Bashkise se madhe. Shtesa ne numrin e punonjesve prej **33 punonjesish eshte bere ne Ndermarjen e sherbimeve, Kopeshtin nr.5 dhe qendren per femijet me aftesi te kufizuara**.

Shpenzime per udhetime dhe dieta per administraten vendore ne funksion te kryerjes se sherbimeve ne pune, eshte nje ze tjeter ne buxhet qe do te planifikohet ne kuader te bashkepunimit dhe permbushjes se detyrave me institucionet e tjera ne nivel qendror e vendor me organizata apo institucione te huaja, per seminare apo trajnime ne qytetete ndryshme te Shqiperise.

Per funksionimin e administrates vendore planifikohen edhe shpenzimet per sherbimet e domosdoshme;



- *Shpenzimet per energjine elektrike.* Bashkia deri ne fund te vitit 2016 ka pasur nje mardhenie korrekte me OSSHE ne zbatimin e kontratave te energjise ne lidhje me furnizimin e energji elektrike per ndricimin dhe ngrohjen e godinave te punes se administrates, per krijimin e kushteve optimale ne ambientet e punes. Ne shpenzimet administrative jane perfshire edhe shumate e faturave te energjise elektrike per kontratat e ndricimit publik e cila eshte planifikuar ne buxhet ne shumen **35,000 mije lek.**
- *Furnizimi me uje,* gjithashtu eshte nje detyrim ndaj NUK i kontraktuar si domosdoshmeri per kushtet e administrates.
- *Sherbimi postar* mbetet nje mjet komunikimi i domosdoshem per tu planifikuar per vitin 2017. Posta gjithashtu paguhet per sherbimin qe ben ne shperndarjen e Ndhimes Ekonomike, Paaftesise dhe grupit te invalideve ne bashkine qender dhe Njesine Administrative.
- *Sherbimi telefonik* permes telefonise fikse , dhe sherbimi i internetit eshte nje domosdoshmeri per tu planifikuar per vitin 2017.
- Nje tjeter forme komunikimi eshte *shpallja dhe publikimi i njoftimeve zyrtare* ne media. Ky sherbim eshte i domosdoshem per komunikim i cili rrit transparencen dhe korrektesine me qytetaret. Gjithashtu ky sherbim perfshin printime dokumentacionesh, ftesash, banerash apo publikime te tjera abonime per shtypin e perditshem.
- *Shpenzime per sherbim ne kancelari* dhe shtypshkrime eshte i planifikuar ne buxhetin 2017, -per furnizimin normal te administrates me kancelari, leter ,bojra per printime dhe fotokopje qe t'u mundesojne punonjesve permbushjen e detyrave dhe objektivave.
- *Mjete dhe sherbime higjeno- sanitare* per institucionin .Shpenzime per buqeta lulesh per ngjarie ceremonial per figurat e artit, sportit, politikes etj, kurora per raste festash apo data perkujtimore.
- *Shpenzime per mirembajtje te mjeteve te transportit* si dhe dhe pagesat per taksave si dhe shpenzime karburanti e llogaritur ne baze normative harxhimi dhe levizjes se nevojshme qe bejne. Me bashkine e re, territori me i madh kerkon shpenzime transporti me te medha per ti mbuluar me sherbime publike, kontrole per cilesine e pastrimit si edhe per te aksesuar bizneset per sa u perket marrjes se detyrimit dhe ankesave ne mospagimin e taksave.
- *Blerje paisjesh* per administraten eshte nje ze me vete ne buxhet, si pasoje e riorganizimit te administrates , kerkesat per paisje elektronike si dhe orendi e paisje jane rritur.
- *Shpenzime per paisje me uniforme te policise,* eshte llogaritur ne baze te numrit te efektiveve te policies si dhe ne zbatim te ligjit 8224, date 15.05.1997 “Per organizimin dhe funksionimin e policies bashkiake”. Qellimi eshte te ofroje sherbim te standartizuar ndaj komunitetit, rritja e imazhit perballe komunitetit me nje prezantim sa me me dinjitoz te Policise Bashkiake.
- *Shpenzime per mirembajtje te paisjeve informatike.* Ne inventarin e Bashkise ka Paisje Informatike te nje pjese e te cilave cilave nuk jane ne gjendje te mire fizike per shkak te amortizimi, dhe si te tilla nevoitet sherbim i vazhdueshem per ti mbajtur ne gjendje pune per te



ofruar sherbim me profesionalizem cilesi dhe korrektesi. Shpenzimi permban vetem koston e materialeve pasi sherbimin e kryen specialist i TIK.

2.2 Sherbime te deleguara te Qkr dhe Gjendjes Civile (paga ,sigurime dhe shpenzime operative)

jane funksione te deleguara per qeverisjen vendore, ne baze te ligjit Nr.139/2015 “Per veteqeverisjen vendore” dhe ne cdo rast funksionet e deleguara shoqerohen me transferta te qeverisjes qendrore per te financuar koston e veprimtarive te ketyre funksioneve. Delegimi behet per te siguruar sherbim sa me cilesor dhe te shpejte ndaj komunitetit.

2.3 Shpenzime per mbeshetje te organeve te zgjedhura, Keshillit Bashkiak dhe Kryepleqte

Kjo pagese eshte detyrim i institucionit qe te kryhet ne formen e honorareve dhe kompesimeve ne perputhje me aktet ligjore ne fuqi. Synimi i bashkise eshte shperblimi ne kohe i anetareve te Keshillit Bashkiak , dhe Kryepleqve , shperblim ky i miratuar nga KB ne baze te legjistacionit ne fuqi. Ne buxhet eshte e planifikuar edhe shuma e shpenzimeve operative per Keshillin Bashkiak e cila do te sherbeje per funksionimin e keshillit ne kushte me te mira, per rritjen e performances se funksionimit dhe mbulimi i shpenzimeve per udhetime dhe dieta ne rastet kur marrin pjese ne takime apo trajnime ne perputhje me detyren e tyre.

2.4 Qendra Polivalente.

Kjo qender eshte ditore per personat e moshuar me probleme **kryesisht sociale**. Financimi i kesaj qendre per pagat, sigurimet dhe shpenzimet operative perballohen nga Ministria e mireqenies Sociale, por kontribuese eshte edhe Bashkia Sarande me ambientet ku akomodohen te moshuarit, me shpenzime operative per mirembajtjen e godines, organizime te eventeve te ndryshme si dhe fond pagash dhe sigurime shoqerore per 4 punonjes.

2.5 Qendra multifunkionale per personat me aftesi te kufizuara.

Kjo qender eshte e para ne llojit te vet ne qytetin e Sarandes. Duke pare nevojën qe kjo kategori ka per mbeshetje sociale Bashkia Sarande mori persiper te buxhetoje kete qender me fondet e veta. Si fillim do te kete nje staf prej 7 personash te gjithë te kualifikuar per personat me aftesi te kufizuara . Do te mbulohen shpenzimet per ndricim ngrohje dhe uje , gjithashtu dhe mirembajtje te ambienteve dhe shpenzime te tjera te nevojshme er funksionimin normal te qendres. Shuma e parashikuar ne buxhet do te jete **5,000 mije leke** brenda fondit te pagave te aparatit te Bashkise.

2.6 Do te kete shtese “fond pagash dhe sig. shoqerore” per personelin e kopeshtit te ri nr.5, i cili pritet te vihet ne funksion kete vit buxhetor. Do te planifikohet edhe fond per pagesat e detyrimeve per energji ekeltrike, uje dhe shpenzime te tjera administrative , te domosdoshme per venien ne funksion te ketij kopeshti ku ne perberje do te kete grupe te ndryshme femijesh, nisur qe nga grupmosha 0-3 vjec. Fondi i parashikuar per kete funksion do te jete **2,100 mije leke** e llogaritur ne fondin e pagave te personelit parashkollor ne transferten specifike.



					/000leke
Programi	Paga+sigurime	Shpenzime operative	Transferta	Investime	Totali
Administrata	103,902	120,022	20,000	103,538	347,462

2.7 Programi i Sherbimeve Publike

Ofrimi i sherbimeve publike per qytetaret, bizneset dhe gjithë komunitetin ne territorin administrative te Bashkise perben shtyllen kryesore te programit buxhetor. Ne kete program shpenzimesh perfshihen disa nga funksionet te bashkise te cilat permbajne sherbimet me jetike per komunitetin ,sic jane : mbledhje, largimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane, mbledhja dhe largimi i ujrave te shiut dhe mbrojtja nga permbytjet e zonave te banuara. Ndertimi rehabilitimi zgjerimi dhe mirembajtja e varrezave publike, sherbimi dhe rinovimi i dekorit te qytetit, mirembajtja e infrastruktures publike, trotualet dhe gropat ne rruget e qytetit, sherbimi mirembajtja dhe zgjerimi i rrjetit ndricues te qytetit. Sherbimet publike ndikojne direkt ne cilesine e jeteses se qytetareve ,si dhe jane vendimtare ne zhvillimin e ekonomik te qytetit. Bashkia Sarande eshte e angazhuar te garantoje per te gjithë territorin dhe qytetaret e saj sherbime publike cilesore, pamvaresisht vendodhjes se tyre. Gjithashtu bashkia do te garantoje rritjen e transparences ne lidhje me ofrimin e sherbimeve publike dhe ta orjentoje ate sipas nevojave te qytetareve.

Aktualisht Ksamili, Çuka, Berdeneshi, Gjashte ,Metiq ,Shelegar kane sherbim te plote apo ne pjesen me te madhe te mbledhjes dhe trajtimit te mbeturinave. Sherbimi i pastrimit ne qytetit kryhet nje here ne dite dhe ne sezonin turistik 2 here ne dite. Larja e 28% e rrugeve te qytetit behet 1 here ne 2.5 dite Larja e tregut te shumices dhe e tregut te fruta perimeve behet nje here ne jave. Larja dhe dezinfektimi i kazaneve behet 7 kontejnere ne jave dhe per periudhen qershor shtator 15 kontejnere ne jave. Per vitin 2017 fondi i planifikuar per sherbimin e pastrimit eshte **45,000 mije lek** dhe per perpunumim e mbetjeve eshte planifikuar **16,000 mije lek**.

Persa i perket furnizimit me uje te pijshem te njesise administrative Ksamil Bashkia Sarande ka trasheguar detyrime per energjine elektrike ne Shumen 84 mil leke te cilat do te shlyhen te ndara ne tre vitet e ardhshme. Per vitin 2017 jane planifikuar **25,000 mij leke** per te shlyer detyrimet e prapambetura. Sistemi i kanalizimeve te ujrave te zeza eshte pjeserishti sistemuar, por me problematike jane kanalizimet ne fshatrat dhe njesine administrative. Sistemi i ujrave te ndotura ka impjant perpunimi vetem per qytetin e Sarandes. Persa u perket fshatrave ky sistem eshte i pa aplikuar ende dhe kjo gje krijon problematika te konsiderueshme sidomos gjate veres.

Mirembajtja e varrezave publike te qytetit me ato te njesise administrative nuk administrohen njelloj dhe sipas te njejtit standart. Situata e mirembajtjes eshte permiresuar por ka ende pune per te bere si ne qytet ashtu dhe ne njesine administrative.



Ne Bashkine e madhe ofrohet ndricimi rrugor i qytetit pothuajse ne te gjithe territorin . Megjithese cdo vit kryhen investime ne rrjetin e ndricimit publik ka ende nevoja per linja te reja ne lagjet periferike te qytetit por sidomos ne njesine administrative. Cdo investim ne funksionin e shtim rrjetit elektrik shoqerohet me nevojën per fondet shtese peperballuar shtesat e konsumit te energjise elektrike, e cila do te pasqyrohet ne buxhet. Per vitin 2017 do te vihet ne eficence studimi per nje PPP per te zevendesuar ndricimin actual me ndricim ekonomik , partneritet ky qe do te kthehen me kursim energjie pas nje periudhe qe do te shlyhet investimi ne asetet e rrjetit te ndricimit publik.

- **Shpenzimet per mirembajtjen ndricimin publik** eshte zeri kryesor ne programin e sherbimeve publike i cili eshte planifikuar **11,000 mije lek**. Ketu perfshihet mirembajtja e e rrjetit ekzistues edhe per shkak te amortizimit te larte, por edhe shtimin e rrjetit elektrik ne zonat ku mungon ndricimi rrugor , kryesisht ne zonat rurale dhe ne periferite e qytetit;
 - Per vitin 2017 do te shtohen 100 cope ndricues me koka,
 - Do te shtohen 10 cope prozhektore per evente,
 - Do te zevendesohen 1,800 ndricues te fuqive te ndryshme me llampa ekonomike,
 - Do te behen 10 pika lidhje te reja me OSHE,
 - Shtim linja te reja me kabell dhe koka ndricimi 3,250 ml.
- **Shpenzime per gjelberimin sigurojne i planifikuar 3,500 mije lek ne buxhet;**
 - Mirembajtjen e 40,000 m² sip te gjelberuara sarande dhe ksamil (29,500 m²/6500m²).
 - Shtimin e lulishteve te reja ,2100 m² ne Sarande dhe 1200 m² ne Ksamil,
 - Ndertimin e nje sere lulesh 350 m² ne Metoq.
 - Zevendesimi i pemeve te munguara, mbjellja e bukenvileve,
 - Nderhyrje ne lulishten Sinagoga , lulishtja tek rrapi dhe bulevardi N. frasheri duke I rritur nivelin 20 cm.
- **Shpenzime per dekorin i planifikuar 3,000 mije lek ne buxhet, planifikohet te kene keto nderhyrje;**
 - Boje fosforishente per sinjalistiken rrugore 1,100 kg
 - Tellaro te gatshme dekori per festat e fundvitit 100 cope
 - Shirita zbukurues me llampa led 1920 ml
 - Flamuj kombetar 100 cope



- Tapet jeshil per kende lojnash 80 m²

• **Mirembajtje te infrastruktures publike i planifikuar 9,260 mije lek ne buxhet, parashikon;**

- Riparim trotuare me pllaka betony 630 m²
- Ndertim mur tulle dhe betoni 65,5 m²
- Kuneta me pllaka guri, bordure pemesh 490 m²
- Bojatisje kangjellash ekende lojnash 1250 kg boje
- Mirembajtje dhe zevendesim kangjella, puseta dhe kapak pusetash 250 cope.

Programi	Paga+sigurime	Shpenzime operative	Investime	Totali
Sherbimet publike	52,550	35,270	-	88,270

2.8 Programi i zhvillimit ekonomik dhe turizmit.

Per vete natyren qe ka qyteti i Sarandes turizmi si aktivitet ndersektorial, eshte i lidhur me shume aktivitete ekonomike dhe ka nje ndikim te jashtzakonshem pothuajse ne te gjithe sektoret e ekonomise, sidomos ne biznesin e hotelerise, njesite tregetare, njesite prodhuese, profesionet e lira deri tek turizmi familjar, bizneset e sezonale etj. Ai udheheq zhvillimin ekonomik pasi kontribon direkt ne krijimin e vendeve te punes, zhvillim lokal dhe urban.

Politikat kryesore ne te cilat do te mbeshtetet Bashkia do te jete:

Industria e Turizmit te jete shtylla kryesore e ekonomise per te gjithe territorin e saj, ne te gjithe muajt e vitit dhe nepermjet politikave te promovimit aktiv, turizmi te kthehet ne nje mjet integrimi te territoreve me pak te zhvilluara ne menyre qe te gjitha resurset e bashkise se madhe te jene ne funksion te zhvillimit ekonomik dhe mirqenies se popullsisë. Synimi do te jete nxitja e nje zhvillimi te qendrushem, te ekuilibruar ekonomik nepermjet politikave te bashkepunimit, edhe me sektorin privat si elementi me i rendesishem ne mardhenien me frekuentuesit e Sarandes dhe Ksamilit.

Nepermjet botimeve te guidave turistike, qendrave te informacionit ne sezonin e veres, hartave turistike, publikimit ne faqen web te Bashkise Sarande, organizimi i panairove me pjesemarrjen e bizneseve qe operojne ne territorin e Sarandes, organizimi i nje sere eventesh kulturore dhe artistike pergjate vitit, Bashkia eshte ne mbeshtetje te turizmit pergjate gjithe vitit.

Per realizimin e aktiviteteve dhe projekteve te programit te turizmit si edhe promocioni qe do te behet per turizmin do te jete **6,200 mij leke**.



2.9 Programi i bujqesise dhe zhvillimi rural

Zhvillimi i zonave Rurale synon te sjelle ekonomine ne barazpeshe me popullsine qe jeton ne keto zona. Synimi do te jete shfrytezimi i gjithe kapaciteteve bujqesore ne funksion te zhvillimit te modelit fshat mje nje infrastrukture rrugore dhe nentokesore te sherbimeve komunale . Sektor i rendesishem dhe me nje impakt te ndjeshem ne ekonomine e kesaj zone eshte peshkimi dhe kultivimi i midhjes ne liqenin e Butrintit.

Rreth 32% e popullsise jetojne ne zonat rurale qe mbulojne rreth 60 % te territorit. Bujqesia, kullotat dhe me pak pylltaria jane sektoret kyc per perdorimin e tokes dhe menaxhimin e burimeve natyrore ne zonat tona rurale.

Prioritet ne keto zona kemi:

- Mbrojtja e tokes bujqesore nga ndertimet kaotike.
- Rehabilitimin e rrjetit te drenazimit dhe ujitjes si domosdoshmeri per zhvillimin bujqesor.
- Investime ne infrastrukturen bujqesore sidomos ne sistemin e ujitjes dhe kullimit per te mbrojtur nga permbytja.
- Nderthurja e investimeve ne sektorin bujqesor me sektorin turistik.
- Promovimi dhe marketing i produkteve bujqesore dhe blektorale, duke nxitur dhe mbeshtetur kulturat specifike te cdo zone.

Situata e kanaleve kulluese ka qene e renduar, dhe investimi per ti vendosur ne funksion te bujqesise ka munguar prej shume vitesh. Ne vitin aktual jane kryer investime te konsiderueshme te cilat kane permiresuar ndjeshem situaten. Per vitin e ardhshem do te krijohet drejtoria e sherbimeve Bujqesore dhe Pyjore e cila do te asistojte direkt ne problematikat e zonave rurale dhe do ti ndjeke ato deri ne zgjidhje.

Per realizimin e aktivitetit dhe projekteve te Programit te Bujqesise dhe zhvillimit rural planifikohet nga transfertat specifike ne vleren **5,306 mije leke**.

Programi	Paga+sigurime	Shpenzime operative	Investime	Totali
Ujitja dhe kullimi	1,232	4,074		5,306

2.10 Arsimi Parauniversitar dhe edukimi.

Ne Bashkine e re, detyrimi per mirembajtjen e godinave arsimore eshte gati dyfishuar. Situata ne sistemin arsimor ne zonat larg qytetit ka qene shume problematike, ku per nje peridudhe shume te gjate nuk ka pasur nderhyrje riparimesh dhe mirembajtje te godinave apo te zevendesimit te paisjeve te



amortizuara. Qysh prej bashkimit territorial ka filluar nderhyrja ne ambientet e kopeshteve dhe shkollave te fshatrave, por nevojat jane shume me te medha nga mundesite qe disponojme. Nga transferta specifike mundesohen vetem pagat dhe sigurimet e punonjesve mbeshtetes te arsimit baze dhe stafit mesimdhene ne institucionet parashkollore, dhe persa i perket mirembajtjes, ngrohjes dhe ndricimit fondet perballohen nga vete Bashkia.

Nga fondet e bashkise sigurohen mjete pastrami ambientesh, kancelari, zevendesim te paisjeve elektrike dhe atyre hidraulike ne cdo fillim viti te cilat demtohen nga keqperdorimi i nxenesve dhe ne kete menyre sigurohet blerja e materialeve te ndryshme per sherbimet mbeshtetese per 8 shkolla dhe ne 11 kopeshte dhe nje cerdhe femijesh. Sigurohet edhe riparimi i paisjeve dhe orendive ne te gjitha ambientet shkollore, dhe ne shume raste zevendesohen me te reja ne varesi te mundesive qe ka bashkia per tu financuar. Gjithashtu sigurohet rimbushja e fikeseve te zjarrit per sigurine e ambienteve ku rrine femijet. Pothuajse ne te gjitha keto ambiente ka nevojte per investime ne rikonstrukcion godinash, instalimesh, sistemesh hidraulike dhe sidomos paisjesh mesimore dhe laboratorike te cilat jane ne gjendje shume te papershtatshme per ambiente edukimi, ne te cilat investohet pjeserisht ne nevojat emergjente nga bashkia cdo vit, por keto fonte behen te paperfillshme perballe nevojave te shumta qe kane keto ambiente. Ne 3 kopeshte dhe ne Çerdhen e femijeve eshte siguruar furnizimi me ushqim dhe funksionimin gjate gjithë dites. Do te vihet ne funksion kopeshti nr.5 ne Lagjen 2 te qytetit, qe per stafin kujdestar dhe mesimor do financoje bashkia, po ashtu edhe per shpenzimet per uje drita, ngrohje dhe paisjen me materialet dhe mjetet e nevojshme per funksionimin normal te tij.

Me fonde nga transferta specifike behet edhe rimbursimi i transportit te femijeve dhe mesuesve te arsimit parashkollor dhe te mesem sipas legjistacionit ne fuqi..

Programi	Paga+sigurime	Shpenzime operative	Investime	Totali
Arsimi	12,936	17,805		30,741

2.11 Sherbimi Social

Ne Sarande ndodhen dhe funksionojne qendra sociale si institucione publike ashtu edhe organizata jofitimpruresse vendase dhe te huaja, duke krijuar nje “klime” humanitare ne gjithë qytetet te cilet kane krijuar nje rrjet mbeshtetes per shtresat ne nevojte. Bashkia vete ka dy qendra per te moshuarit me problematika sociale dhe ekonomike per te cilet perkujdeset nje staf i tere per tju siguruar nje ambient sa me te ngrohete dhe familjar.

Shtepia e femijes eshte gjithashtu nje institucion shteteror per femijet jetime sociale, ku edhe bashkia ka rolin e vet sidomos per femijet jorezidente, per te cilet bashkia financon qe ne keto ambiente te trajtohen edhe keta femije pa mbeshtetje dhe me problem te theksuara sociale dhe ekonomike. Gjithashtu nen kujdesin e bashkise behet miremnajtja e ambienteve te qendrimit te femijeve si edhe rinovim paisjesh ne raste te vecanta. Femijet ne shtate rruge jane identifikuar dhe numri i ketyre femijeve eshte zvogeluar si rezultat edhe i funksionimit te gjithë mekanizmave dhe politikave qeveritare dhe joqeveritare kunder fenomenit te femijeve ne rruge.



Ne Bashki sa strukture te vecante me specialiste te fushes per grate dhe femijet e dhunuara. Jane trajtuar 203 raste gjate ketij viti qe jemi, dhe konkretisht trajtimi konsiston ne takime ne banesat e tyre, me ndihma ushqimore dhe veshmbathjesh, libra per femije etj. Gjithashtu ne raste festash jane organizuar festa nga bashkia ku kane festuar femije te rruges pa perkraje, po ashtu edhe grate e dhunuara. Nje kontribut ne keto financime ka qene edhe projekti per “grate e dhunuara” te iniciuar dhe financuar nga PNUD. Ka pasur bashkepunim te ngushte ligjor me shoqerite civile dhe institucionet shteterore ne rastet kur eshte denoncuar dhe konstatuar raste dhune ne familje per t’ju ardhur ne ndihme viktimave te dhunes. Bashkia ka qene pjese e aktiviteteve te organizuara nga projekti “save the children”, gjithashtu kemi qene perfshirje sociale per komunitetin Rom me ndertimin e banesave te nje pjese te ketij komuniteti.

Me investimin e PNUD eshte bere rehabilitimi dhe pershtatja e nje pjese te ambienteve te godines se ish shtepise se oficerave per tu ngritur nje qender per femijet me aftesi te kufizuara. Bashkia do te perfshihet finansciarisht dhe do marri persiper organizimin me ane te vendosjes se stafit te kualifikuar per kete kategori femijesh, si dhe do te jete pergjegjese per mirefunksionimin e saj. Fillimisht do te startoje me 7 punonjes te kualifikuar per kete kategori femijesh dhe me pas do te shikohet menyra e funksionimit per te bere permiresime atje ku duhet, pasi situata do te jete delikate dhe pergjegjesia e konsiderueshme.

- Gjithashtu nga Bashkia trajtohen me ndihme ekonomike nga te ardhurat e veta eshte 150 familje dhe nga buxheti i shtetit trajtohen 180 familje. Me hyrjen e ligjit te ri per ndihmen ekonomike qe prej dt. 01.09.2016 , ka ndryshuar menyra e trajtimit te familjeve me ndihme ekonomike, perfshire ketu edhe familjet qe trajtohen me te ardhurat e bashkise, qe ne menyren e aplikimit e cila behet on line dhe me kriteret e barabarta me familjet qe perfitojne nga buxheti i shtetit. Aplikimet do te kryhen nga data 1-10 te cdo muaji. Nga Buxheti i shtetit trajtohen **1,950 persona** me aftesi te kufizuara.
- Ne buxhetin e vitit 2017 eshte perfshire edhe fondi prej 500 mije leke per bursa per nxenesit te cilat plotesojne kriteret e vendosura ne ligj, qe do te eprballohen me te ardhurat e Bashkise.
- Per te ardhur ne ndihme familjeve ne nevojte dhe per te trajtuar raste te vecanta te konstatuara keto me akte verifikimi nga personeli i ngarkuar per kete qellim eshte planifikuar **3,500 mije lek**.

					/000leke
Programi	Paga+sigurime	Shpenzime operative	Transferta	Investime	Totali
Sherbimi Social		4,000	206,000		6,200

2.12 Kultura dhe Arti



Me konfigurimin e ri administrative Saranda shenderrohet ne territorin me te volitshem per zhvillimin e kultures duke e kthyer ne nje pike reference te terheqjes se turistave vendas e te huaj. Ne hartën administrative te Bashkise Sarande ndodhen 120 monumente si trashëgimi kulturore. Ne synojme fuqizimin e struktures dhe mireadministrimin e institucioneve aktuale te kultures se Bashkise. Si pikenisje eshte menaxhimi dhe administrimi i institucioneve kulturore artistike, duke e kthyer si nje promovuese te denje te vlerave te rralla turistike, kulturore, historike etj.

Koferenca komberate e Turizmit starton aktivitetet promovuese te vlerave turistike, historike, tradicionale etj, ku marrin pjese eksperte te fushave te ndryshme te cilet sjellin pervojat dhe eksperienat e tyre ne sherbim te turizmit ne Sarande.

Festa e midhjes e organizuar ne Sarande e Ksamil eshte nje promovim jo vetem i vlerave te ketij produkti te rralle por edhe promovimi i kulinarise tradicionale te zones se Sarandes. Me pjesemarrje edhe te bizneseve te tjera nga e gjithë Shqiperia behet e mundur promovimi i vlerave turistike dhe tradicionale te Sarandes. Pjesa e programit jane edhe nxitja dhe zhvillimi i jetes kulturore dhe artistike pjesë e te cilave eshte edhe Qendra Kulturore. Muzika Folklorike dhe qytetare e trevave te jugut, bejne te mundur gjallerimine jetes artistike te Sarandes. Panairi i suvenireve eshte gjithashtu nje aktivitet i larmishem ku marrin pjese anetare nga te gjitha trevat Shqiptare ku bejne te njohur tek e turistat dhe te qytetareve te Sarandes traditat dhe vlerate shqiptareve ne te gjitha koherat dhe i sjellin keto nepermjet punimeve me dore te suvenireve duke perfaqesuar keshtu edhe zonat dhe kulturat nga vine.

Nje pike e rendesishme promovuese te vlerave historike e tradicionale eshte edhe muzeu i artit dhe ai i tradites, te cilet qendrojne te hapur per turistat vendas edhe te huaj. Per vitin qe lame pas nga Bashkia ne bashkepunim me Ministrine e Kultures u be e mundur miratimi dhe financimi i marrjes dhe i ruajtjes se fondit te pikturave nga Muzeu Kombetar te cilat u ekspozuan ne Galerine e arteve ne Sarande, gje qe eshte e para here qe ndodh nje gje e tille per kete fond te rendesishem pikturash. Edhe kjo dha efektin e saj promovues ne gjallerimin e jetes artistike dhe kulturore ne kulmin e frekuentimit te Sarandes nga turistat.

Eshte bere e mundur gjithashtu ndricimi i galerise, vendosja kamerave te sigurise, vendosja e sistemit te kondicionimit per ruajtjen e pikturave, u sigurua me ruajtje fizike te godines se Galerise per periudhen e qendrimit te fondit te pikturave, administrimi ruajtja dhe mirembajtja e arkivit te muzeut.

Kinoteatri i Sarandes eshte nje ambient i rendesishem per zhvillimin e aktiviteve kulturore e artistike por ambjenti i kesaj godine nuk ofron kushtet e nevojshme per zhvillimin e aktiviteve sidomos ne sistemin e ndricimit, amortizimin e godinave nga jashte e brenda dhe paisjeve te saj. Per shume kohe ka munguar investimi ne keto ambiente dhe eshte e domosdoshme nderhyrja me investime per permiresimin e kushteve ne keto ambiente, por pamundesia financiare nga ana e Bashkise ka bere qe ky aset i rendesishem te jete ne te njejten gjendje .

Buxhetimi i programit te kultures

Per realizimin e aktiviteve te kultures dhe sherbimeve promovuese eshte planifikuar **6,200 mije lek**

/000leke



Programi	Paga+sigurime	Shpenzime operative	Transferta	Investime	Totali
Kultura		6,200			6,200

2.13 Rinia dhe sporti

Nepermjet ketij programi do te mbeshtetet administrimi dhe funksionimi i klubit shumesportesh, dhe Klubi i futbollit “Butrinti”. Ne perberje te klubit shumesportesh Bashkia do te mbeshtesi ekipe te disiplinave te ndryshme.

Politikat e ketij program eshte krijimi i infrastruktures mbeshtetese dhe bazes material per zhvillimin e proceseve stervitore te ekipeve te shumesporteve.

Ne mbeshtetje te klubit “Butrinti” do te behet financimi , me qellim stabilizimin e gjendjes se veshtire financiare te tij dhe me pas per zgjidhje afatgjate te problemit duke rritur frymen e financimit nga sektori privat.

Po punohet per te krijuar nje tradite per aktivitetet sportive te pervitshme ne komunitet. Aktivitetet do te zhvillojne traditen ku te rinjte dhe te rejat e Sarandes shoqata ose klube sportive nga vendi ose rajoni te garojne mes tyre.

Aktualisht sporti me i zhvilluar dhe traditor eshte shahu dhe noti, ekipet e te cilave marrin pjese ne te gjitha takimet kombetare dhe rajonale prej te cilave kubi i shahut “ Butrinti” eshte shpallur kampion kombetar.

Meshtetje u behet edhe ekipeve te volejbollit dhe te basketbollit, duke u krijuar ambiente te pershtatshme stervitore si dhe ju kemi vene ne dispozicion trajnere per stervitje.

Buxhetimi i programit te shumesporteve eshte planifikuar 2,020 mije lek pa llogaritur pagat dhe sigurime shoqerore te punonjesve.

2.14 Shpenzimet per transferta te brendshme

Për vitin 2017 janë parashikuar në masën **33,000 mije LEK** ose 5.8 % e buxhetit. Në këtë zë është përfshirë gjithashtu edhe fondi prej **10,000 mije LEK**, që do të shërbejë për pagesën e detyrimeve të Bashkisë Sarande lidhur me **shlyerjen e vendimeve gjyqësore të formës së prerë kryesisht per kontrata sherbimesh te lidhura shume vite me pare , per personelin e larguar nga sherbimi civil vite me pare, si dhe shpronetime gjithashtu te viteve te meparshme.**

Gjithashtu jane planifikuar **13,000 mije lek** per klub sport “Butrinti sh.a” detajimi i ketij fondi do te jete bashkengjitur ketij relacioni. Ky fond do te jete ne mbeshtetje te skuadres se futbollit per kapercimin e nevojave financiare te domosdoshme qe ata kane.

Nje nga zerat e kesaj transferte eshte edhe ajo e ndihmes ekonomike qe eshte planifikuar **4,000 mije LEK** nga te cilat 500 mije jane planifikuar per bursat e nxenesve. Ky fond teshte planifikuar 3,000 mije



lek me pak krahasuar me vitin 2016 per arsye se do te aplikojne ne buxhetin e shtetit te gjithë personat qe per arsye kriteresh te klasifikuara nuk mund te aplikonin dot me pare.

2.15 Niveli i fondit rezervë të Bashkise dhe i Kontigjencës për ruajtjen e mosrealizimin e te ardhurave për vitin 2017, parashikohet të jetë në masën **5,000 mije LEK**, përkatësisht 2,000 mije fond rezervë dhe 3,000 mij LEK fond kontigjence për ruajtjen e deficitit.

2.16 Fondi per likuidimet e detyrimeve te prapambetura.
Si pasoje e reformes administrative territorial, bashkimit te drejtave dhe detyrimeve te njesise administrative , eshte krijuar nje borxh ndaj te treteve te cilat, eshte e detyruar bashkia e re ti shlyeje. Ne baze edhe te rekomandimit te Ministrise se financave per te planifikuar shlyerjen deri ne 2019 per vitin 2017 eshte planifikuar fondi prej **25,000 mije lek**.

2.18 Financim projektesh nga BE.
Ne kuader te aplikimit nga ana e Bashkise me projekte te ndryshme ne programin IPA nga fondet e BE , do te financohen projekte te fituara per vitin 2017. Ligjet ne fuqi lejojne parafinancimin nga buxheti i Bashkise me te cilat mund te filloje projekti te aplikohet dhe me deklarimin e shpenzimeve, behet rimbursimi i shpenzimeve, me perjashtim te TVSH nga fondet e miratuara per projektet nga KE. Fondi per kete program do te parashikohet **2,500 mije leke**.

2.19 Venia ne eficence e strukture se Emergjences Civile.

Me shtimin e kopetencave, transferimin e funksioneve dhe zgjerimin e territorit u krijua nje strukture per emergjencat civile e cila funksionoi pjeserisht, kryesisht ne periudhen e sezonit turistik, per mbrojtjen e territorit nga zjarret, per perballimin e situatave evakuese, mobilizimi i komunitetit, sensibilizimi i tij, krijimi idhe krijimi grupeve vullnetare me qellim permiresimin e sigurise publike, te rritjes se sigurise se jetes, mbrojtjes se prones se qytetareve,bizneseve, aseteve administrative, pasurive natyrore dhe ambjenteve te ndryshme publike. Trajtimi ne buxhet behet per here te pare dhe ne planifikohet ne shumen **1,000 mije leke**.

2.20 Detyrimet ndaj Keshillit te Qarkut:

Ne zbatim te ligjit 139/ 2015 “Per Veteqeverisjen Vendore” ,Qarku financohet nga kuotat e anëtarësisë së bashkive përbërëse, të përcaktuara në buxhetin vjetor të bashkive. Kuota e anëtarësisë për financimin e buxhetit të qarkut per vitin 2017 do te jete **1,000 mije lek**.

2.21 SHPENZIMET NGA TRANSFERTA SPECIFIKE

- **Konvikti i shkolles se mesme**, me nje fond prej **18,051** mije lek nga te cilat do te edhe fondi i destinuar per investime ne kete institucion nga te cilat 5,297 mije lek jane planifikuar investime per rinovimin e ambienteve te konviktit.



- **Arsimi parashkollor, i** cili perfshin te gjithë punonjesit mbeshtetes te arsimit te parashkollor gjithesej **73** punonjes me nje fond **45,467** mije leke per paga dhe sigurime shoqerore.
- **Arsimi parauniversitar**, po ashtu perfshin personelin mbeshtetes te shkollave te mesme prej **5** punonjesish me nje fond prej **2,321** mije lek per pagat dhe sigurimet shoqerore.
- **Mbrojtja nga zjarri**, ka transferuar te gjitha kopetencat dhe detyrimet ne Bashki me nje personel prej **17** personash dhe fond **13,681 mije lek** nga te cilat 12,394 mije lek per paga dhe sig shoqerore si dhe 1,287 mije lek per shpenzime operative.
- **Administrimi i pyjeve**, me nje personel prej 3 punonjesish dhe fond page 1,630 mije lek, sigurime shoqerore dhe 213 mije lek shpenzime operative, gjithashtu kane transferuar kopetencat dhe detyrimet ne Bashkine e Sarandes.

Tabela 7 . Buxheti I bashkise Sarande sipas programeve buxhetore dhe burimeve te financimit

Programet	Pagat	Kontrib. e Sigurimeve Shoqerore	Mallra dhe Sherbime	Te Tjera Transfer. Korrente	Shpenzime Kapitale te Trupezuara	shuma
Administrata e Bashkise	89,500	14,402	120,022	20,000	103,538	347,462
Programim Turizmi			1,500			1,500
Pastrim & Perpunim per mbetjet urbane	-	-	45,000			45,000
Shpenzime per tarifat e Landfilldit Bajkaj			16,000			16,000
Totali	89,500	14,402	182,522	20,000	103,538	409,962
Qendra kulturore & shume sportet	15,550	2,589	5,350			23,489
Totali	15,550	2,589	5,350	-	-	23,489
Sport Klub Butrinti sh.a				13,000		13,000
shuma				13,000		13,000
Arsimi 8 Vjecar Parashkollor	1,363	227	14,340			15,930
Arsimi i mesem i pergjithshem			850			850
Cerdhe e femijeve	9,660	1,686	2,615			13,961
shuma	11,023	1,913	17,805	-	-	30,741
Ndermarja e Sherbimeve Publike	45,050	7,500	35,720			88,270
shuma	45,050	7,500	35,720			88,270
Qendra Polivalente	1,600	270	200			2,070
Shtepia e Femijes			1,015			1,015
shuma			1,015			1,015
Totali	162,723	26,674	242,612	33,000	103,538	568,547
Transferta Specifike						
Konvikti I shkolles se mesme	6,500	1,400	5,730		4,421	18,051
Arsimi parashkollor	38,961	6,507	-			45,468
Arsimi parauniversitar	1,989	332	-			2,321



Mbrojtja nga zjarri	10,673	1,721	1,287			13,681
Administrimi I pyjeve	1,397	233	213			1,843
Ujitja dhe kullimi	1,154	78	4,074			5,306
Totali	60,674	10,271	11,304	-	4,421	86,670
Investime nga Buxheti I Shtetit					603,421	603,421
Transferta e kushtezuar						
Mbrojtje Sociale (PAK)						191,000
Mbrojtje Sociale (Ndihme Ekon.)						15,000
SHUMA TOTALE	223,397	36,945	253,916	239,000	711,380	

1,464,638

3. INVESTIMET

Për Programin e investimeve publike do të angazhon **103,538 mij lek** nga te ardhurat e Bashkise ose 18% e burimeve buxhetore në dispozicion, dhe **603,150 mije lek** nga buxheti i shtetit ose 42% te buxhetit total per vitin 2017. Ai mbështet zhvillimin e politikave e të prioriteteve të miratuara dhe të pa implementuar gjatë vitit 2016 si dhe, projektet në *proçes zbatimi apo prokurimi*. Me përparësi do të zhvillohen projektet që kanë *impakte më të ndjeshme e më të shpejta* në komunitet, duke krijuar më në kohë, kushte për kohezion ekonomik e social, për veprimtari publike, *zhvillim të balancuar e të qëndrueshëm* në pikëpamje të teritorit e të funksionit.



Tabela 8
Investimet e programuara per vitin 2017

Nr	Programet e buxhetuara	Nga te ardhurat e Bashkise	Nga Buxheti i shtetit	Totali
1	Investime per aparatin	2,930	0	2,930
2	Investime ne token bujqesore	-	116,500	116,500
3	Investime ne infrastrukturen rrugore	61,421	269,000	330,421
4	Investime ne sherbimet publike	29,541	5,500	35,041
5	Investime per Sportin	6,101	0	6,101
5	Invnestime per arsimin dhe art	993	212,150	213,143
7	Studime projektme	2,597	0	2,597
	Shuma	103,583	603,150	706,733

- Financimet nga buxheti i shtetit nepermjet instrumenti te saj FZHR per vitin 2017 do te behet kryesisht per projektet ne proces te nisura ne vitet e meparshme dhe qe do te perfundojne ne vitin 2017. Projekti i ri qe pritet te jete risi ne kete pakete eshte projekti i “Rikonstruksioni dhe shtrim i ruges bujqesore te fushes se Palit ” ne Metoq ,projet ky qe do te kete impakt shume pozitiv ne aktivitetet e fermerëve te asaj zone si dhe rritjen ekonomike per popullsine e asaj zone qe jetojne kryesisht me bujqesi.

Tabela 9. Investimet me financime nga FZHR per vitin 2017

Nr	Emertimi i projektit te investimit	Parashikimi per vitin 2017		
		Vlera e plote investimit	Investime te reja	Investim ne proces mbartur nga 2016
Menaxhimi i tokes bujqesore				
1	Rehabilitimi I KU Ksamil i poshtem +15 KS Metoq	21,500		21,500
2	Rikonstruksion dhe shtrimi I ruges bujqesore te fushes se fshatit Pal	95,000	95,000	
	<i>Shuma</i>	116,500	95,000	21,500
Ruge rrjete dhe transport publik				
3	Rikonceptim dhe Rivitalizimi i qendres se qytetit te Sarandes, rruga e Flamurit	87,000		87,000
4	Ndertim Asfaltim rruges nr 5, loti II & III	182,000		182,000
	<i>Shuma</i>	269,000		269,000
Rjete ne ujesjelles dhe kanalizime				
5	Permiresimi i rrjetit te ujrave te zeza Hotel Butrinti-Kanal i Cukes	5,500		5,500



	<i>Shuma</i>	5,500		5,500
Investime ne arsim				
6	Ekokampusi	208,000		208,000
7	Investime per rikonstruksione ne ambientet e konviktit si dhe terrene sportive	4,421		4,421
	<i>Shuma</i>	212,421		212,421
	Totali Investimeve	603,421	95,000	508,421

Edhe për vitin 2017 mbeten konstante, **politikat e angazhimit me prioritet** të burimeve në mbështetje të realizimit të **programit të investimeve kapitale**. Për këtë qëllim janë parashikuar të destinohen rreth **40 %** e burimeve të pakushtëzuara, ose në tregues absolut rreth **41 milion** lekë. Krahasimisht me shpenzimet për investimet publike të programuara në **buxhetin AM, të miratuar** nga Këshilli Bashkiak, me **Vendimin nr.26 date 29.07.2016** për vitin 2017, ato janë më të larta. Kjo shpreh **përgjegjshmëri** në angazhimin e burimeve vendore me fokus, mbështetjen me prioritet të **programi të zhvillimit të imputeve vendore**.

Si edhe gjatë vitit 2016, në programin e investimeve të vitit 2017, është rritur pesha e investimeve kapitale në infrastrukturën publike e në sektorët socialë si në arsim, kulturë, në infrastrukturën mbështetëse turistike e atë mjedisore. Vazhdojnë të mbeten prioritet investimet për përmirësimin e furnizimit me ujë të banorëve, për rikonstruksionin e rrjetit të UZ-ve, ato në rivitalizimin e infrastrukturës urbane, në përmirësimin e infrastrukturës agrare etj.

Si rezultat i investimit të realizuar do të shënohen nivele të përmirësuara në marrdhëniet e, në shërbimet ndaj qytetarëve. Në bashkëpunim me USAID-in, bashkia **për vitin 2017**, ka vendosur në funksion **zyrën me një ndalesë** duke ndërtuar një **model eficient dhe vizionar** në ofrimin e shërbimeve të ndryshme administrative ndaj qytetarëve. Kjo strukturë në thelb, do të përmirësojë cilësinë dhe do të shkurtojë kohën e dhënies së informacionit qytetarëve. Pranë kësaj zyre qytetarët adresojnë kërkesat e ankesat dhe aplikojnë për shërbime të ndryshme, në ndryshim nga më parë, në një ambient të vetëm. Kjo do të sjellë përmirësime të marrdhënieve institucion-qytetar duke u shërbyer në mënyrë të përgjegjshme-transparente dhe në një afat sa më të shpejtë.

Ndërkohë, hartimi e miratimi i Planit të Përgjithshëm Vendor brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit 2017 do të shërbejë, për përcaktimin e implementimin e politikave zhvilluese **në 15-20 vjetët** e ardhshëm. Do të orjentohet drejtimet strategjike e skenarët e zhvillimit vendor. Do të fusë në normalitet zhvillimin urbanistik, turistik e mjedisor të njësisë vendore. Do të krijohen të gjitha alternativat e hapësirat e nevojshme e të mundshme për një zhvillim më të qëndrueshëm, të integruar e më cilësor ekonomik, social e mjedisor. Është përgatitur **draft programi për eficientë e energjisë** ç'ka do të krijojë mundësi e alternativa të reja për zhvillimin e projekteve mjaft të rëndësishëm në fushën e rritjes së eficientë së energjisë e të cilësisë së ndriçimit.

Me peshë të konsiderueshme do të jenë edhe për vitin 2017, investimet që do të financohen nga buxheti nacional, nëpërmjet granteve të FZHR-ve e donatorëve të ndryshëm. Në vlerë absolute



financimet për këto projekte parashikohet të arrijnë në rreth **607,842 mijë lekë** . Brenda tremujorit të parë të vitit 2017 do të përfundojë e vihet në zbatim projekti i madh prej rreth **8.5 milion €**, për përmirësimin e furnizimit me ujë dhe të rjetit të UZ-ve, kredi e bankës gjemrane të investimeve, (KfW-së). Do të vihet në funksion projekti i ndërtimit të KUZ-ve në njësinë administrative të Ksamilit me vlerë të përgjithëshme **4.7 milion €**, **i financuar nga BE**. Do të përfundojë projekti i **rrugës 5**, lot.II+III-të , me një vlerë të përgjithëshme, së bashku me shpronësimet, **403 milion lekë, të financuar nga FZHR-ve**. Po nga **FZHR-ve do të vazhdojë të financohet projekti në proces, ndërtimi i shkollës**

së arsimit 9 vjeçar, si strukturë përbërëse e masterplanit të **Eko-kampusit arsimor**, në zonën e Vilës, **me vleftë 330 milion lekë**. Gjithashtu, brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2017, do të përfundojë e vihet në funksion **projekti i rivitalizimit të qendrës urbane e i rrugës së Flamurit**, me vleftë të plotë **102 milion lekë**. Po me fondet e buxhetit nacional do të investohet në **përmirësimin e infrastrukturës agrare**, të rrugëve rurale të prodhimit bujqësore, **siç është rikonstruksioni e shtrimi i rrugës bujqësore të fushës së Palit me gjatësi 4.65 km e vlerë 95 milion lekë**.

Siç pasqyrohen edhe në tabelën përkatëse, kemi aplikuar dhe jemi në negociata për të përfituar në vitin 2017 edhe, financime të reja nga FZHR-ve, pranë të cilit kemi dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në afatet e parashikuara, në të dy fazat, **12 projekteve** të fushave të ndryshme, me një vlerë të përgjithëshme prej **2.2 miliardë lekë**. Jemi në negociata për të siguruar fonde nga burime alternative për **restaurimin e kthimin në identitet të Shëtitores egzistuese prej 1 km, me vleftë 99.5 milion lekë**, duke rritur kapacitetet e performancën turistike të qytetit. Kemi aplikuar edhe për disa projekte të rëndësishme për rritjen e përmirësimin e kapaciteteve të infrastrukturës arsimore si për rikonstruksionin e thellë të **shkollës së arsimit, 9 vjeçar, “A.SHEME” si dhe, për rikonstruksionin e shkollës së arsimit të mesëm të përgjithshëm, “H.Tahsini”**.

Për ti hapur rrugë zhvillimit dhe për të zbutur efektin limitues të burimeve në ndryshim nga viti 2016 jemi duke shfrytëzuar mundësi e burime të tjera alternative. **Kemi aplikuar** , me miratim në parim nga Këshilli Bashkiak **me rreth 14 projekte**, të fushave të ndryshme, për të përfituar në kuadër të **programeve IPA, për periudhën 2017-2020** ose, nga burime të tjera alternative si nga **UNDP-ja, IADSA**(i konvertimit të borxhit për zhvillim). **Kemi fituar si partner në një prej** projekteve dhe, presim që në një afat të dytë të jemi përfitues edhe në projekte të tjera. Po kështu , me mbështetje të **PNUD-it, Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim**, realizuam rikonstruksionin e Qendrës Multifunktionale Komunitare , dhe brenda gjashtëmujorit të parë 2017 do ta vëmë në funksionim, për të trajtuar fëmijët me aftësi të kufizuara e një ambient rehabilitues për gratë e dhunuara. Do të vazhdojë investimi i nisur, i sponsorizuar nga **Raiffasen bank** , për ta përfunduar brenda muajit prill 2017, për përmirësimin e performancës së shëtitores egzistuese, duke ngritur parkun e skulpturave, **“magjia e detit”**. Në të njëjtën kohë janë në proces, duke kaluar fazat e miratimit e të aprovimit, **projektet të BB**. në kuadër të programit pilot, për mbështetjen e zhvillimit urban e të turizmit në bregdetin e Jugut. Do të këmbëngulim që, për vitin 2017, të zhvillohet, me financim nga burime alternative , projekti mjafti i rëndësishëm si ai për përmirësimin e furnizimit me ujë i zonës periferike të qytetit me vlerë **373 milion lekë**, filluar nga zbatimi e financimi që në viti 2014 dhe, nuk është zhvilluar më tej. Po kështu jemi në negociata intensive me autoritetet qendrore për të financuar edhe rikonstruksionin e rrugës hyrëse ura e gajdarit-kryqëzimi i bregdetit, në qafë Gjashtë, për ta sjellë në parametra normal të standarteve të kohës, si pjesë integrale e hyrjes së qytetit turistik. Në kohën që do të bëhen konkrete këto projekte kemi detyrimin t’ju bëjmë me dije. Forcimi i



bashkëpunimit rajonal e ndërkufitar me partner vendet e tjera anëtare të BE-së, do të përbëjë një prioritet në qeverisjen vendore në vazhdim.

Nga t'ardhurat e veta, janë programuar të financohen kryesisht do të mbështeten projektet e miratuara nga Këshilli një vit më parë që aktualisht janë në proces zbatimi apo prokurimi që, në vlerë arrijnë në 103.5 milion lekë.

Shpresoj që të gjej **mirëkuptimin e mbështetjen Tuaj** për **miratimin e p/programit buxhetor** të vitit 2017 që, sipas vlerësimit tonë, përbën **variantin më optimal të mundshëm për zbatim.**



